

TEKNIKAT PËR SILAZHIM OPTIMAL

Referat nga z. Franz Riegler, konsulent dhe bashkëthemelues i Austria Prämix sh.p.k



Në mbarështimin e lopëve për qumësht, kostot e ushqimit përcaktojnë pjesën më të madhe të kostos së përgjithshme të prodhimit. Prandaj, po i jepet gjithmonë e më shumë prioritet si ushqimit të lopëve të qumështit ashtu edhe cilësisë së ushqimit voluminoz. Për të arritur rendimente të larta të qumështit, lopët duhet të konsumojnë ushqime voluminoze të cilësisë së lartë. Metoda e re e përgatitjes së foragjereve „extra dry“ mundëson përfitim të ushqimit me cilësi.



Cilësia, konsumimi i ushqimit si edhe kërkesa e përgjithshme për ushqimin bazë dhe atë me koncentrat shpjegohen nëpërmjet 4 shembujve të mëposhtëm:

	Madhësia e tufës	Rendimenti/vit	Ushqimi bazë/ Energji	Koncentrat	
	Lopë	Kg/Lopë	MJ/KG TS	Konsumi i ushqimit Total LTH %	Marrja e ushqimit Total LTH%
Shembulli A	70	6.000/6.0	243/100	143	100
Shembulli B	60	7.000/6.0	217/89	143	100
Shembulli C	60	7.000/6.0	243/100	120	84
Shembulli D	60	7.000/6.7	244/100	99	69

Shembulli B: Rritja e rendimentit të tufës nëpërmjet gjenetikës.

Shembulli C: Nëpërmjet ushqimit voluminoz dhe cilësor, konsumi i ushqimit për çdo kafshë rritet si pasojë e rritjes së rendimentit nga ushqimi i prodhuar në fermë, si pasojë ulen shpenzimet për koncentrat, konsumi i të cilave ndikon pozitivisht në mjedis.

Kështu reduktohen shpenzimet për ushqimin me shumë kalori. Pakësimi i blerjeve të lëndëve minerale ndikon pozitivisht mbi mjedisin (problemet e gropave të plehut).


Shembulli D: Përveç kësaj nëpërmjet rritjes së nivelit të energjisë në ushqimet voluminoze në masën 10 % konstatohet një konsum i reduktuar i koncentratit . Kjo ul kostot e ushqimit.

Si silazhohet me cilësi optimale?

Bazat për një silazhim të mirë gjenden tek cilësia e materialit të masës së foragjereve. Llojet e barit me tretshmëri të lartë janë të rëndësishme. Përmbajtja e celulozës tek bari duhet të arrijë rreth 23% dhe të mos kalojë 25%. Krahas rënies së tretshmërisë, përçindja e lartë e celulozës ndikon në shtypjen e gropës së silazhit dhe cilësinë e ushqimit. Për silazhim optimal, nevojiten njohuri të specializuara dhe teknike korrjeje moderne dhe efikase. Për t'ia ofruar fermerit këto të dyja, kompania Petinger investon në kërkime dhe zhvillim të produkteve dhe makinerive bujqësore.

Intensiteti i përgatitjes


Qëllimi i përgatitjes është që të “preket” shtresa e fortë në fijet e barit. Masa për silazhim lëshon lehtë ujin dhe thahet më shpejt. Përgatitja realizohet me makineri me dhëmbëzat në formë v-je, të cilat janë të radhitura në formë spirali. I rëndësishëm është kalibrimi i saktë i makinës silazhuese. Silazhi duhet të përgatitet pa e dëmtuar strukturën e ushqimit. Më tej është studiuar raporti i ndërsjelltë me intensitetin e përgatitjes së silazheve dhe aftësisë silazhuese të foragjereve në eksperimente në fushë, por edhe në laboratorë. Nga kontrollat rezultoi se përgatitja e fortë dhe intensive sjell shpesh humbje të mëdha. Kujdes i veçantë për problematikën e mësipërme duhet për përgatitjen efektive dhe me kujdes.



1. Në qoftë se kërcelli i bimës është i paprekur, shtresa mbrojtëse ndaj avullimit është akoma në funksion të plotë.



2. Kërcell i përgatitur fort: dëmtime të dukshme në strukturë, humbje nëpërmjet harxhimit të energjisë nga thërmimi.



3. Kërcell i përgatitur korrekt: shtresa që pengon avullimin, struktura e dëmtuar jo e dukshme.

Teknika e depozitimit


Për të arritur nivelin optimal të tharjes në fushë, duhet që pas kositjes masa e foragjereve të lihet shtrirë në mënyrë uniforme. Gjerësia e kositjes përdoret si orientim për sipërfaqen maksimale të avullimit. Këtu u kontrolluan gjithashtu edhe zgjidhje të tjera në eksperimentet në fushë së bashku me eksperimentet në ambiente të klimatizuara.

Tharja në fushë

Niveli i shfrytëzimit është në varësi të rendimentit në fushë. Në kushte kur LTH është nga 4t deri në 5t në fillim të procesit të tharjes, përmbajtja e LTH arrihet në masën rreth 30% - 50 % vetëm në kushtet optimale të tharjes. Nëpërmjet një shtrimi uniformë të masës së njomë në fushë, LTH dyfishohet brenda një dite dhe bie deri në 30%.

Nëpërmjet shpërndarjes uniforme në një sipërfaqe më të madhe realizohet tharja optimale e masës. Në kohën që bari është i përgatitur në rreshta, mund të përdoret vetëm 30% - 50% e fushës në varësi të fazës së tharjes.

Aftësia silazhuese e foragjereve




Nëpërmjet përgatitjes (shtypjes së kërcellit me makineri) ndryshohen aftësitë fiziologjike të ushqimit. Aftësia për avullim rritet dhe bakteret e acidit laktik mund t'a përdorin më mirë sheqerin për fermentim. Si pasojë, vlera e pH në silazh ulet më shpejt dhe cilësia e ushqimit rritet.

Analiza të silazheve të ndryshme

Silazhi i barit	I trajtuar me tharje ekstra	Normal
Masa dhe përmbajtja e thatësirës (%)	40,00	34,50
Përmbajtja e celulozës (g/ kg TM)	210,00	211,00
Hiri (g/kg TM)	119,00	154,00
Vlera energjitike (MJ/kg TM)	6,60	6,10
Proteina e tretshme (g/kg TM)	157,00	146,00
Nh3/N – ges. (%)	6,00	9,00
Acid butirik (%)	0,00	0,10
Acid laktik (%)	2,44	1,59

Si të kursesh kohë?



- 11 -

Ecuria e punës thjeshtësohet dhe kështu kursehet kohë. Shpërndarja e menjëhershme dhe e përdorur shumë herë nuk nevojitet më. Nëpërmjet reduktimit të procesit të parë të shpërndarjes së barit thjeshtësohet procesi i punës në fermë dhe nuk krijohen probleme organizative të makinerive.

- Koha e shkurtër e qëndrimit në fushë (humbjet nëpërmjet frymëmarrjes arrijnë 1–3 % në ditë)
- Rritja e shpejtë e mëpasshme numërohet çdo ditë (deri në 200 kg LTH/ha në ditë).
- Ulja më e shpejtë e vlerës së pH në silazh, më pak rrezik nga fermentimi i gabuar (kalbëzimi), cilësi më e mirë.
- Më pak shpërndarje (çdo proces shpërndarjeje 1–2 % humbje substancë e thatë).
- Më pak ndotje të ushqimit, më pak hi në silazh.

Përparësitë e mëdha të teknologjisë së re

- Koha më e shkurtër e tharjes së fushës, më pak rrezik në kohë të keqe.
- Në kushtet optimale sasia e energjisë mund të përmirësohet deri në 10%.
- Aplikimi i reduktuar i makinerive.
- Kursim i kohës së punës, menaxhim më i thjeshtë në ndërmarrje.
- Më pak humbje nga tharja e tepërt, sasi më e lartë e përmbajtjes së proteinave.
- Më pak shkelje të fushës.
- Më së miri i përshtatshëm për koordinim të tepërt të makinerive.

Teknika me tharje ekstra “super i thatë” që shpërblehet shpejt:

Silazhimi më i mirë me 10% më shumë përmbajtje energjie shton marrjen e ushqimit të ashpër deri në 10%. Kjo kursen deri në 30% aplikimit me koncentrat. Kursime të mundshme të ushqimit me koncentrat për çdo lopë deri mbi 700 kg.

Në një tufë me 1,5 lopë/ha dhe 1.750 lekë/100 kg do të thotë një fitim i 17.500 lekë/ha. Çdo proces shpërndarjeje i kursyer (rreth 25 minuta/ha) ul edhe një herë koston me rreth 1.750 lekë/ha.

Në kushtet optimale, me teknikën “super të thatë”, mund të arrihet një fitim i përbashkët i 14.000 – 21.000 lekë për hektar.